

VITI XVII, NUMRI 4 / PRILL 2013

FOREVER

HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA



HAWAII
GLOBAL RALLY
2013 21-29 APRIL



FOREVER - falnderim global



Tashmë vetëm disa ditë na ndajnë nga ajo që ti hypim avionit që nisët për në Hawaii. A e ke marrë biletën e avionit? A mund ti thuash faleminderit Rex Maughan-it për atë që bëri të mundur të vizitosh këtë ishull të mrekullueshëm dhe atje të mund të marrësh një çek të merituar nga fitimi i firmës?

Për çdo njeri vjen një moment në jetë, kur e ndjen se duhet ti thotë faleminderit dikujt për atë që ka marrë nga jeta. Edhe unë dua ti shpreh mirënjohjen time Rex Maughan-it, Gregg Maughan-it, Aidan O'Hare për atë që për ne, distributorët e Hungarisë dhe të rajonit të saj bënë të mundur të ngitem në lartësi të tilla, të cilat dikur vetëm mund ti kishim endërruar. Na takon tu themi faleminderit për ndihmën e pakufishme që kemi marrë vazhdimisht nga Drejtoria e kompanisë Forever, për mundësitë e paimagjinueshme dhe të pashoqe, që në bazë të planit të marketingut, Rex Maughan dhe Gregg Maughan kanë siguruar për çdo njerin në botë. Për këto udhëtime të mrekullueshme, për aktivitetet që na frymëzojnë çdo vit, për botkuptimin dhe njohuritë që fitojmë. Me siguri edhe ti do të dëshiroje ti përkisje kësaj skuadre, dhe që personalisht ti thoshe faleminderit? Ngjitu në podium dhe vetëm kaq thuaj: "Thank you Rex, thank you Gregg, thank you Aidan."

Ashtu duket si një gjë e vogël, por brënda këtij falnderimi, është gjithë jeta jote, lufta jote, nderi yt, njerzillëku yt. Është një kënaqsi dhe një nder i madh për mua që të mund të udhëheq një skuadër të tillë për në ishujt Hawaii. Faleminderit juve, Rex, Gregg, Aidan! Kur Brian Tracy vizitoi Hungarinë, dhe u bë pjesë e sistemit tone të trainimit global, të titulluar Trainimi Diamantëve të Foreverit, natyrisht edhe Miki Berkics, unë dhe të tjerët e falnderuam shumë here për atë që bëri për distributorët e Foreverit të Hungarisë dhe të rajonit të saj. Në përgjigje të kësaj Brian shkroi si më poshtë:

"Në letrën e apostullit Pál drejtuar filipejve thekson: Mos u shqetësoni për asgjë, por me faljet dhe lutjet tuaja në çdo rast shprehni me mirnjohje dëshirat tuaja para zotit.

Është vullneti i Zotit që të falem për vëllezërit e mi, pranaj falem edhe për ju. Më shkruani, se cila është ajo për të cilën do të dëshironit ti luteshit Zotit në Qiej dhe që të përqaftuar në kongregacion do të faleshit me lutje, për çka keni marrë si ndihmë me bekimin e Zotit. Duhet ta dini që Zoti i Qiejve prët lutjet tuaja. Mendoni deri në fund, cilat janë ato gjëra, që nuk ju ecin mire në jetën tuaj. Çfarë problemesh keni në familje dhe më drejtoni lutjen tuaj! Bashkë me ju dhe për ju do të falem dhe do ta shikoni e provoni prekjën shëruese të Zotit në jetën tuaj dhe jetën e të dashurve tuaj."

Në Rally-in Global të vitit të ardhshëm, dhet të shkojmë dy here kaq. Kemi akoma rreth një vit që të shkojmë atje dhe të shprehim falnderimet tona në atë podium.

Përpara Forever Albania!

DR. SÁNDOR MILESZ
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Thank
You



FOREVER DIAMOND TRAINING

Berkics Miklós

FOREVER



DIAMOND TRAINING

BUDAPEST | 16-17 SHKURT- E DIELË



Trainimin nga Diamanti Miklós Berkics nuk e neglizhon askush që do të jetë i sukseshëm në këtë biznes – kemi shkruar në revistën Forever të muajit Mars, ku dhamë përmbledhjen e ditës së parë të takimit. Në këtë numer kemi pjesën e dytë me kalibra të rinj.

DR. MILESZ SÁNDOR- DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Sponsori në ndërtimin e këtij biznesi, natyrisht është figura kyçe. Sikurse shprehen: ai ndihmon edhe thjeshtë me prezencën e tij. Nuk ka rëndësi se cili person është, mbasi edhe ndihma është me shumë shkallë. „Sponsori më i mirë në botë është sponsori im, sepse ai është sponsori i të gjithëve – thotë dr Sándor Milesz duke patur parasysht themeluesin e kësaj firme Rex Maughan. Sipas definicionit të Sándorit, sponsor është ai që jo vetëm të prezanton mundësitë e këtij biznesi, por edhe të ndihmon e mëson papushim. Po si duhet të jetë sponsori i mirë? Për këtë drejtori i përgjithshëm na numeron një varg cilësish. Drejtuesi i vërtetë ndërmjet të tjerash duhet të jetë i besueshëm, i përpiktë, të ruajë kontaktet, të thotë të vërtetën, të jetë i gatshëm për të ndihmuar, të jetë model, i vetëdijshëm për objektivat, gazmor, njeri që mendon, karizmatik, organizator i mirë, frymëzues, optimist, i durueshëm, i gjithanshëm, i ndershëm, i dashur dhe që shikon vazhdimisht nga e ardhmja. Duket si e pamundur, por megjithatë për shumë rrejtndërtues këto cilësi janë të njohura. „Ju jeni më të mirët, kushdo që vjen këtu për të mësuar” – thotë Dr Sándor Milesz dhe thekson: „të gjithë ju jeni të përkushtuar që të jeni diamantë, vetëm merrni një vendim!”



LEKTORI BRIAN TRACY – SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Brian Tracy është një nga lektorët dhe autorët më të suksesshëm në botë. Si i ftuar në Trainimin e Diamantëve, dëshiron të theksojë pikpamjen sipas të cilës as falimenti as suksesi nuk vijnë kot: në qoftë se ndjek shembullin e njerzve të sukseshëm, po atje do të mbrish ku janë ata. Por për këtë duhen bërë gjërat e duhura në vendin e duhur dhe në radhën e duhur. „Rrethanat i kufizojnë mendimet e tua, ato të bëjnë ai që je” – thotë Tracy, pastaj radhit idetë kyçe të suksesit: drejtues i mirë, produkte dhe plan marketingu të shkëlqyera, një strategji e mirë humane, shpejtësi, fokusim... - të gjitha mund të mësohen!

Shumë studime janë drejtuar tashmë , se çfarë e bën dikë një drejtues të mirë. Të gjithë këta kanë një tipar të përbashkët: kanë një vizion domethënës dhe të rëndësishëm për të ardhmen dhe besojnë në të” „Dijet, talenti, aftësitë, të gjitha janë në dorën tënde, – thotë Tracy- në qoftë se ke bërë hapin e parë, vjen i dyti, pastaj i treti. Rëndësi ka të mos hezitosh, por të veprosh shpejt!” Meqënëse 90% të të ardhurave tona, na i jep 10% punë, ia vlen të përzgjedhim (madje ta hedhim në letër) ku do ti investojmë energjitë tona. Sipas lektorit ia vlen të merremi me më pak gjëra, por me to të merremi në mënyrë intensive. „Objektiva dhe planifikim: për këto dy gjëra aftësohu!”



JÓZSEF SZABÓ - ZAFÍR MENAXHER

Shtatëmbëdhjet vjet më parë József Szabó, nuk do ta kishte menduar që do të jetonte nga multi level marketingu, dhe nuk do ta kisha besuar që do të mbrija deri këtu – shprehet ai. ndërsa tani ndodhet në podiumin e Foreverit, dhe si i pari i Foreverit në Hungari na garanton: „As vetë nuk mund ta kuptosh se ku do të mbrish me këtë biznes, dhe çfarë rezerva të fshihen. Edhe unë në atë kohë vetëm kaq kërkoja, të provoj të jem midis më të mirëve. Por e rëndësishme është, që çfarë hapi do të bësh javën e ardhshme. Askush nuk mund ta bëjë në vendin tënd, ti vetë duhet ta nisësh. Sikurse shprehet ai „ky është biznes i njerzve të thjeshtë, të ndershëm, të pastër, i atyre që duan diçka më shumë nga jeta dhe që nuk duan të bëjnë një jetë mediokre“. Dhe në Trainimin e Diamantëve pikërisht këta njerëz janë mbledhur, jo vetëm nga Hungaria, por nga i gjithë rajoni. Sipas József Szabó një nga virtytet e firmës Forever është vëllazërimi i gjithë rajonit. „Një mijë lloj njerzish, por një objektiv, vetëm kështu bota do të jetë më e mirë!“ Lektorit thërret në skenë anëtarët e brezit të ri: rrjetndërtuesit e mundshëm të të nesërmes që sot janë 17-18 vjeç. Eshtë interesante ta mendojmë, sa ishim kur filloi historia e Foreverit...“ Çdo gjë është e mundshme, vetëm besoni edhe sot në këto fjalë!“ – përshëndet duke përfunduar József Szabó.





ISTVÁN HALMI – MENAXHER DIAMANT-ZAFIR

Ata që vijnë rregullisht në takimet e Ditës së Suksesit, e njohin tashmë historinë e István Halmi-n dhe Rita Mikola Halminé. Por gjithmonë të vjen mirë ti dëgjosh: se çfarë rruge përshkohet në Forever, dhe përmes vështirësive deri ku mund të arrihet. Çifti Halmijo vetëm e nisi nga hiçi, por gjithmonë ishin të duruar, dhe asgjë nuk e konsideruan të pavlerë, kur kjo i shërbente qëllimeve të tyre. Për tan ë plan të parë qëndronte lumturia dhe jeta familjare, dhe për këtë punuan fort – veçanrisht në rrethin e njerzve ku punonin. Istváni e filloi si shturman avioni, por krahas kësaj punoi vazhdimisht për kualifikimin e vet, lexonte, siguroi dy diploma, por kur kishte nevojë, pa bërë fjalë punoi shofer kamioni, ndërsa Rita mësonte fëmijët. Më vonë, hapën së bashku një biznes pijesh, por nuk i bënë dot ballë konkurrencës. Pas

shumë vështirësish ju futën sipërmarrjes MLM. „Kur isha i ri kisha dy objektiva: të bëhesha milioner dhe fëmijët e mi ti edukoj sipas vetes time. Këtu i realizova të dyja. Ju përvëshëm punës, dhe arritëm rezultat sepse punuam shumë. Kemi bërë shumë miq, që ia vlen mundimin që kemi kaluar. Nga ai moment kam shkruar se me rastin e 50 vjetorit të lindjes time do të arrij të jem diamant- dhe besoj se do ta realizoj sepse kjo është ëndërra ime!”

MIKLÓS BERKICS – DIAMANT MENAXHER

„Suksesin e paraprin rruga që bën, nuk është e lehtë, por sidoqoftë ia vlen ta çosh deri në fund.” Këtë na tregon Miklós Berkics, natyrisht jo kaq thjeshtë, por përmes shembujve emocionalë, argëtues, dhe plot surpriza. Është një gjë e bukur kur shikon, se edhe ai ashtu si edhe të gjithë ne ecën e pengohet nëpër labirinthe. Megjithatë... „vallë ku qëndron ndryshimi i atij që ka arritur nivelin e diamantit”- shtron ai pyetjen vetes dhe neve.

„Me pasion, me vendosmëri, si i dalldisur: edhe diamantët e tjerë të tillë janë, jo vetëm unë” – thotë ai. „Suksesi nuk u arrit pa vështirësi, por nuk u dorëzova, sepse e shkrova diku, që një ditë do të arrij në majë, kur rruga të jetë më e shkurtër dhe më e lehtë. Shumë herë të vijnë sinjale se duhet ta lësh, por ti vazhdo se e di çdo të thotë të lidhësh një kontratë. Dhe mrekullia qëndron në atë që në seminarin e ardhshëm, „do të jesh dubluar”. Në ndërtimin e këtij biznesi gjithmonë është e nevojshme modestia, në çfardo nivel që të arrish. Në qoftë se prej këtej kthehesh në shtëpi po me atë personalitet tëndin, me të cilin erdhe, nuk do të ketë ndryshim, por në qoftë ndryshon, atëhere do të ndryshojë edhe rezultati. Fito ato zakone që ndjekin diamantët, dhe atëhere edhe ti do të bëhesh diamant!”



Në qershor mbrrin në Hungari Michael Strachowitz, trajnuesi numër një i Europës, ndërtues i suksesshëm rrjeti dhe këshilltar i firmës. Sot veç network marketingut angazhohet gjithashtu edhe në fushën e marketingut të drejtpërdrejt dhe strukturor. Tashmë njohurit e tij i kanë përdorur me mijra distributorë nga shumë vende të Europës.

MICHAEL **TRAJNUES**
STRACHOWITZ



NË ÇDO NJERI FSHIHEN MUNDËSI TË PAFUNDME

Tashmë je takuar më parë dhe ke folur me distributorë hungarezë dhe sllavo-jugor. Çfarë përshtypje të kanë lënë?

Për mua gjithmonë ka qënë kënaqësi e madhe të takohem me distributor hungarezë dhe sllavo-jugor të Foreverit. Janë shumë të përkushtuar, mund të perceptohet, që e adhurojnë të punojnë në Forever, dhe prandaj janë të hapur për të mësuar dhe për tu zhvilluar. Janë njerëz shumë të përzemërt dhe të dashur.

A ke marrë ndonjë reagim prej tyre në vazhdim të vizitës tënde?

Po, natyrisht ka patur reagime, sidomos në faqet e internetit. Në të gjitha rastet, kur mbaj trajnime në Forever, jashtëzakonisht shumë vetë më bëjnë të njohur, dhe marr shumë komente. Të gjitha komentet janë të sinqerta, të qarta dhe me humor, gjë që tregon, se si funksionojnë bizneset e personave.

Si një lektor i shquar çfarë pret nga seminari?

Mezi pres, që të takohem me disa miqt e mi të vjetër; me drejtues dhe me një numër të madh distributorësh të rinj. Jam i impresionuar, që sa pjesëmarrës do të jenë në takim (siç kam dëgjuar, do të flas para më shumë se një mijë vetave). Qëllimi im është, që t'ju tregoj dhe t'ju them dëgjuesve, që janë në vendin më të mirë, në momentin më të përshtatshëm. Mendoj, se kurrë nuk ka patur rast më të mirë se sot, për të ndërtuar biznesin - Forever

Çfarë mendon për krizën e zhurmshme ekonomike në ditët tona?

Jetojmë kohën e ndryshimeve. Kur gjërat rreth nesh ndryshojnë, ajo gjithmonë është e shoqëruar edhe me avantazhe dhe me disavantazhe. Disa vuajn nga ndryshimi, kur të tjerë shikojnë brenda saj mundësinë. Por pa ndryshim nuk ka zhvillim. Kohët e vjetra – kur na edukuan në atë mënyrë, që mëso një zanat, siguro një vend pune dhe puno atje deri në fund të jetës -, mund të themi, që morrën fund. Ka nevojë për më shumë nga ata njerëz, në të cilët gjendet shpirti i sipërmarrësit; për ata, që janë dakort në atë, që ata janë përgjegjës për jetën e tyre private dhe profesionale në të gjitha fushat. Jam i sigurt në atë, që njerëzit që krijojnë rrjetin i përkasin këtij tipi!

Do të na jepje ndonjë këshillë të mirë duke e parë nga ajo, se si mund ta trajtojmë krizën, cili është qëndrimi i duhur?

Krizën e konsideroj ashtu, si një sfidë. Këtu është koha, që të

dalim nga zona komforte dhe të fillojmë të veprojmë. Në gjuhën kineze për fjalën krizë përdorin po atë gërmë, si për mundësin. Sa njerëz të mençur, apo jo? E ashtuquajtura krizë ekonomike e përgjithshme, gjithmonë ka qënë me efekte pozitive për biznesin në fushën tonë, sepse gjithmonë e më shumë njerëz kërkojnë alternativë dhe mundësi të re, kështu mund ti antarësojmë ata. Në të kaluarën, kur pati rënie ekonomike në Gjermani, ne kemi pasur drejtimin e lëvizjes për çdo rast. Këshilla më e mirë, që mund të jap: Mos shiko prapë nëpër ato dyer, të cilat janë mbyllur mbrapa teje! Në vend të tyre më mirë shiko nëpër ato dyer të reja të shumta, që qëndrojnë të hapura përpara teje!

Çfarë mesazhi do t'ju jepje distributorëve tanë?

Jam i bindur, që në çdo njeri fshihen mundësi të pafundme, dhe nga kjo buron edhe ajo mundësi, që të jetë i suksesshëm, i pasur dhe i lumtur. Kjo është një e vërtetë e përditshme, vetëm që disa herë e harrojmë. Ndodh, që ju japim hapsirë rrethanave të jashtme, të cilat na kushtëzojnë ne në atë, që ta jetojmë jetën ashtu siç duhet. Realiteti është ai, që luhet në mendjet tona, dhe jo ai, që shohim me sy dhe dëgjojmë me vesh. Çdo ditë kujto idetë e mëposhtme: Jeta është madhështore, dhe edhe Ti ashtu je! Çdo gjë mund ta arrish, për të cilat vetëm mendon apo vetëm beson. Biznesi Forever është mundësia më e mirë, për të treguar dhe vërtetuar atë!

Çfarë mund të përfitojnë ata distributorë që do të jenë pjesëmarrës në qershor në Trajnimin e Diamantëve të Foreverit të Miklós Berkicsit?

Është jashtëzakonisht i rëndësishëm, që të merrni pjesë në këtë takim monumental, sepse këtu mund të përjetoni atë, se çdo të thotë të jesh anëtar i një skuadre të suksesshme. Seminari ndihmon për t'ju afruar më shumë firmës dhe mundësis së mrekullueshme, në të cilën beson, dhe në të njëjtën kohë të përjetosh forcën pozitive të komunitetit. Në seminarin tim do ju vërtetoj juve, se sa i thjeshtë është ky biznes, nuk ka brenda asnjë sekret, dhe në realitet kushdo, që dëshiron të punojë, mund të arrijë suksesin e vërtet në biznes. Nga ana tjetër e „thjeshtë” nuk do të thotë, që është edhe e lehtë, prandaj do të flas për atë, se cili është qëndrimi i nevojshëm dhe të menduarit korrekt në interes të asaj, që të krijosh një besim të fort në botën tënde të suksesshme. Për shumë vetë seminari mund të jetë fillimi i një historie madhështore, të mrekullueshme dhe të suksesshme. Të gjithëve ju duhet të lidhen, askush nuk mund t'ja lejoj vetes, që të mbetet jashtë saj!



Pse duhet ta mbash me krenari distiktivin tënd?

Foreveri është firma e zemrës

Nga një endërr u krijua një biznes multi miliardash.

Para 35 vjetësh Rex Maughan krijoi një firmë të tillë që më në fund do të ndrshonte jetën e miliona vetëve në botë. Duke e ndjerë që motivimi i vetëm i njerzve është dëshira që të ndjehen të vlerësuar, Rex kuptoi forcën e vlerësimit dhe këtë e vendosi në qendër të idevet ë Foreverit. Shpesh prej tij kemi dëgjuar thënien... „Forca e Foreverit është forca e dashurisë”.

Sinqerisht besoj dhe e di, se njerzit e ndjejnë dashurinë, kur i vlerëson ata, edhe atëhere kur këtë e bëjmë në mënyrë të thjeshtë. Si simbol i fortë i rezultateve të arritura u krijua distiktivi që tregon arritjet- që tregon dashurinë që ndjejmë për ta dhe për arritjet e tyre.”

Distiktivi i vlerësimit



Çfarë do të vlerësonte më mirë individin dhe arritjet e tij se sa distiktivi me flori dhe gur të çmuar? Ari prej shekujsh është simbol i shkëlqimit, që ka qënë shumë i kërkuar edhe para se të fillonte të shkruarit.

Kur arrijmë nivelet më të larta në planin e marketingut, distiktivet që simbolizojnë sukseset e distributorëve jepen me gurë të çmuar, me karakteristika të tilla të vlerës dhe lluksit si: rubin, zafir, dhe kremi i kemit: diamantët me shqiponjën e artë.

Është simbol i vlerësimit; mbaje me krenari distiktivin tënd!

Bëje zakon të përditshëm mbajtjen e distiktivit – ashtu si hedh parfumin Forever „25Th edition” dhe merr me vete çantën tënde. Ashtu si shumë distributorë të sukseshëm edhe ti të jesh i vetëdijshëm për të edhe kur vrapon për tu takuar me një menaxher Eagle, ashtu edhe kur shkon në supermarket apo në një ndeshje futbollit të djalit tënd. Mbaje çdo ditë distiktivin tënd, vlerëso rolin e tij, dhe të jesh krenar për atë që të simbolizon rezultatet që ke arritur deri tani! Mbaje pa ndrojtje para gjithë njerzve!

Distiktivi i takon Foreverit ai është shënjë që simbolizon rrugën që kalon.

Distiktivi i përket edhe Rex Maughan, njeriut që e kuptoi: duhet ta ndjejmë se jemi të vlerësuar.

Distiktivi i përket atij individi që e mban.

Ai shpreh: „Kam arritur diçka për veten time.”

Vepra; Mbaje distiktivin tënd me krenari!

Distiktivi simbolizon edhe rrugën e bërë. Ato sfida që kemi ndeshur gjatë rrugës, që e kemi bërë për një jetë të tillë që e dëshirojmë.

Ju urojmë suksese për çdo nivel të arritur!



Assistant Supervisor



Supervisor



Assistant Manager



Manager



Senior Manager



Soaring Manager



Sapphire Manager



Diamond Sapphire Manager



Diamond Manager



Double Diamond Manager



Triple Diamond Manager



Centurion Diamond Manager



**WINTER
CHALLENGE
2013**

-PANIC EARLY

LISTA E KUALIFIKIMIT

NIVELI 3.

Maczali Lászlóné
Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin
& Dr. Seres Endre
Mogyoródi Gábor & Soós Anna
Éliás Tibor
Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona
Sega Marjana & Segá Anton
Lomjanski Stevan & Lomjanski Veronika
Izer Zoltán & Lugosi Tünde
Dr. Rokonay Adrienne & Dr. Bánhegyi Péter
Szabóné Dr. Szántó Renáta & Szabó József
Dr. Tumbas Dušana
Vágási Aranka & Kovács András
Heinbach József & Dr. Nika Erzsébet
Dr. Szénai László & Dr. Szénainé Kovács Gabriella
Kása István & Kása Istvánné
Petković Aleksandra & Petković Bogdan
Krključ Ksenija & Ignjatović Milorad
Ugrenović Miodrag & Ugrenović Olga
Kuzmanović Vesna & Kuzmanović Siniša
Knežević Sonja & Knežević Nebojša
Davidović Svetlana & Davidović Milan
Škorić Zoran & Škorić Dragana
Popović Viktorio

NIVELI 2.

Nagy Istvánné & Nagy István
Strboja Jovanka & Strboja Radivoj
Dr. Jović Randjelović Sonja & Randjelović Dragan
Molnár Rudolf & Molnár Ildikó
Šimunić Dinko & Šimunić Sandra
Kis-Jakab Árpád & Kis-Jakabné Tóth Ibolya
Antunović Kata
Tóth Gabriella
Molnár Ferenc & Molnárné Horváth Ildikó
Dr. Kolonics Judit
Pohánka Tamásné
Varga Róbert & Varga-Hortobágyi Tímea
Gojković Dragana
Matula István
Vetrih Leskovar Jožica & Leskovar Vetrih Branko
Beloša Stjepan & Beloša Snježana
Meló Anita & Vasas Tamás
Gavrić Vesna & Gavrić Ivan
Tóth Csabáné
Kovács Annamária & Csávás Péter
Kostyál Katalin & Németh Miklós Márton
Domonyik Enikő & Árva Zsolt
Nakić Marija
Ferencz László & Dr. Kézsmárki Virág

Lehoczky Enikő
Luketa Goran
Hajcsik Tünde & Láng András
Gerő János & Gerőné Jócsák Julianna Katalin
Menkó Éva
Nagy Andrea
Herman Terézia
Vajagic Slobodan
Blašković Siniša
Dr. Hócsi Mária
Žurka Dragana & Žurka Radiša
Buruš Marija & Buruš Boško
Simon János
Dr. Nedić Mirjana
Schleppné Dr. Kász Edit & Schlepp Péter
Mitrović Dragana & Mitrović Nebojša
T. Nagy Sándorné & T. Nagy Sándor
Dézsiné Váradi Erzsébet & Dézsi József

NIVELI I.

Bruckner András & Dr. Samu Terézia
Csizmadia Róbert & Porubszky Marianna
Dr. Fábián Mária
Pável Ildikó
Lipcseiné Vozár Ilonka
Dr. Gróf Ilona & Horváth Tibor
Miklós Istvánné & Tasi Sándor
Jécsy Gyula Lajosné
Utasi Viktor
Dr. Dósa Nikolett
Szabó Bálint László & Szabóné Uhrin Éva
Hegy László & Hegyi Dominika
Molnár Judit
Töreki Győzőné
Vincze Tibor & Vinczéné Sos Katalin
Gellért Judit
Todorović Ksenija
Pintér Lászlóné & Pintér László
Gombás Csilla Anita & Gombás Attila
Kovács Istvánné
Szabóné Varga Zsuzsa & Szabó Imre
Krasnyánszky Jánosné & Krasnyánszky János
Juhász Imréné & Juhász Imre

Lovas István & Lovasné Borbély Éva
Popovac Dušica & Popovac Ratko
Nagy Ádám & Nagyné Belényi Brigitta
Ónodiné Szuhár Edina
Tóth Zoltán
Mázás József
Berecz Zsanett
Tapasztai Zsuzsanna & Hartó István
Stilin Tihomir & Stilin Maja
Horváthné Nagy Márta
Juhász Csaba & Bezzeg Enikő
Mandák Ágnes
Zečević Boban & Zečević Dušanka
Csontos Sándorné
Simon-Jójártné Bárkányi Éva & Simon-Jójárt Gábor
Repac Milan & Repac Stana
Almási Gergely & Bakos Barbara
Fekete Terézia
Berkics Miklós
Halmi István & Halminé Mikola Rita
Paizs Roland
Szatmáriné Seres Marianna & Szatmári Ferenc
Csányi Erzsébet & Szalay Rajmund
Palanca László & Springmann Andrea
Czeglédi Antal & Czeglédiné Hajts Judit
Bara Imre
Velkovska Vecka
Hajdu Kálmán & Hajdu Ildikó Rózsa
Vukoša Jelena & Vukoša Milivoj
Balogh Balázs
Buljin Sava
Csordás István András & Csordásné Tanács Zsuzsanna
Király Antalné
Muszka Tímea & Muszka Ernő
Rosta László
Királyné Tímár Lilla & Király Attila
Izsó Antalné & Izsó Antal
Fülöp Attila & Fülöpné Szabó Szilvia
Kürtös Annamária & Kürtös László
Baletić Sonja & Baletić Ivan
Péter Gabriella & Péter Zsolt
Borbáth Attila & Borbáth Mimóza
Dragojlović Jasmina & Dragojlović Miroslav
Futaki Ildikó

BERKICS MIKLÓS

FOREVER DIAMOND TRAINING

FOREVER 
The Aloe Vera Company

REGIONAL SEMINAR



SÁNDOR MIELESZ DR.
Country Manager



ROLF KIPP
Double Diamond
Manager



BODO SCHÄFER
Trainer



ATTILA GIDÓFALVI
KATI GIDÓFALVI
Diamond Managers



MICHAEL
STRACHOWITZ
Trainer



LOMJANSKI VERONIKA
LOMJANSKI STEVAN
Diamond Managers

2013 8-9 JUNE
SYMA HALL
BUDAPEST

BE PART OF THIS FANTASTIC,
MOTIVATING & EDUCATIONAL
TRAINING!

PRICE OF THE TICKET IS 10.000 HUF/2 DAYS,
TICKETS ARE AVAILABLE AT THE FLP WAREHOUSES.
SYMA HALL, 1146 BUDAPEST, DÓZSA GYÖRGY ÚT 1.



BERKICS MIKLÓS
Diamond Manager



I dashur anëtar i FLP!

Do të dëshironit si dhuratë një kupon udhëtimi me vlerë 150.000 Ft? Në qoftë se blen tani paketën Exclusive Travel Touch, atëherë dhurata është jofjal!

Përkrahësit:
Skuadra e ForeverUtazás



Duke patur parasysh suksesin e madh nga 2 Prilli vazhdon oferta e përbashkët
promocionale e FLP dhe Klubit ForeverUtazás:

Me blerjen e Exclusive Travel Touch me vlerë 150,000 Ft siguron Pjatën e artë që mund ta shfrytëzosh si skonto udhëtimi.

Udhëto dhe pusho me ne, me ForeverUtazás!

Ç' DUHET BËRË:

1. Regjistrohu për një vit në Klubin ForeverUtazás!
2. Pas regjistrimit në faqen www.foreverutazas.hu ofertat e Pjatës së artë ForeverUtazás.
3. Zgjidh udhëtimin dhe lidhu me ne !

Ofertat e udhëtimit do ti gjeni në faqen e internetit www.foreverutazas.hu nga data 15 prill
Udhëtimet ju sigurohen falas juve ose mund tua dhuroni të dashurve tuaj nga 1 Maji deri në 30 Shtator 2013.

MUNDËSITË E KONTAKTIT:

Personalisht: në Qendrën e FLP, Budapest XVIII., Nefelejcs utca 9-11. Telefon: +36 70 7779997 Email: travel@foreverutazas.hu



Mundësi të pakufishme

Ka një histori të një plaku, që kishte kursyer paratë për vite me radhë vetëm për të bërë një xhiro rreth botës. Ishte një endërr e tij e përjetshme që e kishte shtyrë të punonte fort çdo ditë. Kishte prerë pamje të vendeve që kish dëshirë ti vizitonte dhe gërmonte në internet dhe nëpër revista për të gjetur një biletë që mund ta përballonte. Më në fund kishte gjetur biletën ideale me anije për të shkuar në vendin e dëshiruar dhe me çmimin e favorshëm. Ishte i entuziazmuar. Endërra e tij po realizohej. Duke patur parasysh koston e udhëtimit dhe buxhetin e tij të kufizuar, ai vendosi të paketonte dy valixhe. Një me veshjet dhe aparatën fotografikë dhe tjetrë me ushqime të konservuara. Plani i tij ishte perfekt që të zinte vend në kabinën e tij duke evituar eskursionet dhe të mos hante në restorantin e anijes. Do të bënte fotografi nga dritarja e vogël e kabinës së tij dhe prej andej do të sodiste qytetet e bukura të botës.

Më në fund erdhi dita e nisjes. Kabina e tij ishte diçka më e vogël se sa e kishte endërruar, por s'kishte pse shqetësohej sepse dritarja e saj ndodhej në një pozicion pamje të mirë. Për tre javë me radhë ai hante konserva me bizele dhe biskota të thata, duke soditur mrekullitë e botës. Çdo ditë atij i vinte era e ushqimit të shijshëm dhe të bollshëm që vinte nga kuverta. Dëgjonte të qeshurat dhe entuziazmin e udhëtarëve të tjerë që bënin xhiro dhe eskursionë poshtë e lartë. Pastaj natën e fundit stjuardesa si zakonisht e pyeti se në cilin banket të lamtumirës do të dëshironte të merrte pjesë?

„Oh” „nuk mund të marr pjesë në ndonjë prej tyre, sepse jam pak si ngushtë nga buxheti” – u përgjigj plaku.

Stjuardesa e befasuar i shpjegoi plakut, se çdo gjë në anije ishte e përfshirë në çmimin e biletës, duke përfshirë eskursionet dhe vizitat turistike ditore!

„Kjo është e pamundur!”

Ai kishte humbur një shans të veçantë në jetë, sepse kaq kish bërë për tu njohur me kushtet dhe mundësitë që i ofroheshin. Nga që nuk e endërronte një gjë të tillë atij i dukej e pamundur. Ai nuk e shfytëzoi shansin sepse kaq ishte horizonti i tij. Në qoftë se ai do të kishte dalë pak nga kabina dhe të zgjeronte horizontin e tij, ai do të kish shfrytëzuar një mundësi të pakufishme.

Shumë herë jemi dëshmitarë të asaj, që distributorët tanë nuk i kuptojnë mundësitë që fshihen në planin tonë të marketingut, sepse nuk e njohin atë me hollësi, ose ajo që është më e keqe u duket se kjo për ta është e pamundur. Ja një shembull për këtë: mbi 100 distributorë nuk fituan mundësinë e kualifikimit për të marrë pjesë në Rally-in e Hawaii-t vetëm për 100 pikë (CC). Kjo do të thotë se kanë humbur një turne fantastik për vetëm edhe 8 pikë në muaj. Unë ju siguroj se kjo më shumë ka patur të bëjë me besimin se sa me mundësitë për ti realizuar edhe këto pikë!

Boksieri famshëm Muhammad Ali e ka dhënë më së miri shpjegimin për këtë. „ E pamundura është një fjalë e madhe për nerzit e veckël sepse për ta është më e lehtë të jetojnë në botën dhënë gati për ta, se sa të zbulojnë forcën që kanë në vetvete për ndryshim. E pamundura nuk është fakt, por vetëm një mendim. E pamundura nuk është deklaram, por një sfidë E pamundura është një mundësi, ajo është vetëm një moment kalimtar. E pamundura nuk ekziston.”

Kur analizoni muajt e parë të 2013 dhe planifikoni muajt që vijnë pas, kërkoni të gjeni mënyrën për të maksimalizuar mundësitë dhe fshini të pamundurën!

Willie Wonka në filmin e madh e ka përkufizuar këtë më së miri: “Charlie... A të kujtohet çfarë ndodhi me atë burrin që gjeti papritur gjithshka që dëshironte?” “E ç'ndodhi me të, Willie?” “Jeto i lumtur deri sa vdiq.”

Për gjithkënd nga ne ekziston një fund i lumtur në këtë aventurë. Në dash e besoni në mos dashi mos e besoni!

Gregg Maughan,
President i Forever Living Products



FOREVER core

development • recruitment • retention • productivity

Ja disa nga idetë që duhet ti mendoni si ti shfrytëzoni 4 parimet themelore të këtij biznesi:

REGJISTRIMI – RECRUITMENT

- Merr guximin që çdo ditë ti bësh të njohura mundësitë e këtij biznesi edhe me një njeri tjetër!
- Kërko nga kushdo të të rekomandojnë dikë për ti shitur produktet dhe për ta regjistruar si distributor të ri!
- Ki parasysh: që gjithmonë mënyra më më mirë e sponsorizimit është ajo që i regjistruari i ri të bëjë menjëherë një porosi.

RENDIMENT – PRODUCTIVITY

- Mba në mënyrë krijuese lidhje me konsumatorët e tu, që të përdorni sa më shumë produkte me ta!
- Provo produkte që nuk i ke përdorur kurrë më parë, ose kujdesu të zëvendësosh produktet „me Zero pikë” me produktet e FLP!
- Mëso sa më shumë për produktet!

RUAJ LIDHJET – RETENTION

- Ruaj lidhjet me grupin tënd, që çdo muaj të plotësosh qënien aktive me 4 pikë (CC) dhe të jesh shembull për ta.!
- Ndiqi çështjet në mënyrë më efektive!

ZHVILLIM – DEVELOPMENT

- Ndiqi me vëmendje distributorët e grupit tënd, që të dish kush është më afër ngjitjes në një nivel të ri dhe fokusohu tek ata!
- Qëndro edhe një apo ditë më shumë Global Rally apo në takimin e Menaxherëve eagle për të regjistruar të tjerë apo për tu kënaqur që në vendin tënd të kthehesh me forca të shumfishuara!
- Lufto që për Chairman’s Bonus, Eagle Manager apo Global Rally të arrish një nivel sa më të lartë!





HOLIDAY RALLY

Opatija

PERIUDHA E KUALIFIKIMI: I JANAR 2013 DERI 30 PRILL 2013.

KUSH MUND TË KUALIFIKOHET?

Çdo distributor i ri apo i vjetër, që nga niveli aktual ngjitet të paktën një shkallë më lartë në planin e marketingut (nga shkalla e distributorit mund të kualifikohesh vetëm në qoftë se arrin shkallën e supervizorit). Mund të marrin pjesë edhe të risponsorizuarit !

CILAT JANË KUSHTET E NEVOJSHME TË KUALIFIKIMIT PËR KËTË PROGRAM STIMULIMI?

Ngjitu një nivel! Gjatë periudhës të kualifikimit të jesh aktiv (me 4 pikë, nga të cilat 1 pikë në kodin personal) duke filluar nga muaji i parë i plotë, dmth, në qoftë se psh u regjistrove më 15 Qershor 2013, atëhere nga 1 korriku. Nga niveli ekzistues i distribucionit të ngjitesh në planin e marketingut një shkallë (ata që janë në nivelin e distributorit të arrijnë nivelin supervizor).

Ky është niveli i I-rë i Holiday Rally.

Pas kualifikimit, deri në fund të periudhës të kualifikimit , çdo dy muaj të njëpasnjëshëm, përsëri të plotësohen kushtet e kualifikimit, dmth përsëmbull nga niveli i distributorit apo asistent supervizorit, kur ke arritur nivelin e supervizorit në qershor, atëhere të ruash qënien aktive edhe , qershori dhe korriku së bashku si dhe korriku me gushtin bashkë duhet të jenë 25 CC. Në qoftë se u nise nga niveli i supervizorit dhe në qershor arrite nivelin e asistent menaxherit, atëhere krahas ruajtjes të qënies aktive, qershori dhe korriku së bashku dhe korriku me gushtin përsëri duhet të jenë 75 pikë, e kështu me radhë. Ky është niveli i II-të i Holiday Rally.

Në qoftë se je regjistruar në muajin e fundit të periudhës të kualifikimit dhe ke plotësuar kushtet e kualifikimit për Holiday Rally, atëhere në Holiday Rally nuk mund të marrësh pjesë në akomodimin e VIP-ave, por sigurisht je kualifikuar për nivelin e I-rë. Ai që gjatë periudhës të kualifikimit ngjit dy a më shumë shkallë të planit të marketingut, ai në Holiday Rally merr pjesë në akomodimin e VIP-ave, pra ka arritur nivelin e II-të.

AKOMODIMI:

në hotel me 4 yje, duke përfshirë gjithshka.

Bashkpunëtorët e kualifikuar për Nivelin e II-të do të shkojnë me autobus VIP, dhe gjatë aktivitetit do tu shërbehet në bufe VIPash dhe do të ketë pika shitje për VIP-a duke mos pritur në radhë. Bashkpunëtorët e Nivelit të I-rë, udhëtimin e tyre duhet ta mbulojnë me shpenzimet e tyre, por sigurisht mund të marrin falas shërbime të firmës.

KUR DHE KU DO TË JETË HOLIDAY RALLY?

Vendi aktivitetit në Opatija të Kroacisë, 4-5 Tetor 2013



forevergiving
Make a Difference



Të ndryshojmë!

Programi Forever Giving bashkëpron me organizata bamirësie që veprojnë në pjesë të ndryshme të botës për të ndarë me to ndjenjat e angazhimit të zhvillimit humanitar.

Fëmijët tanë janë e ardhmja e njerëzimit. Prandaj Foreveri përqëndrohet në mënyrë të veçantë tek ata, që të arrijë ndryshime në përmasa botërore për ndarjen e burimeve materiale me një kujdes të veçantë dhe për atë që të rinjtë kudo të mund të marrin pjesë në arsimimin e duhur. Përveç kësaj vazhdon luftën kundër varfërisë, urisë dhe kundër mungesës të kujdesit të mjaftueshëm shëndetsor për fëmijët. Gjithashtu në raste fatkeqsish natyrale, përpiqemi që të ndihmojmë sa më shpejtë në ato zona ku funksionon fondacioni ynë apo shoqatat tona të donacioneve. Programi Forever Giving i nxit njerzit për donacione. Në kuadrin e Fondacionit tonë, çdo donator mund të ndihmojë me vetdijen që donacionet me siguri do të mbërrijnë tek ata që kanë nevojë.

Informacion të mëtejshëm për programin Forever Giving por edhe për mënyrën e dhënies të donacioneve mund të merrni duke vizituar faqen tonë të internetit: www.forever-giving.org!



József Sabó-Zafir Menaxher dhe Miklós Berkics-Diamant Menaxher, ambasadorët e Forever Giving të rajonit tonë.



SOARING MANAGER SZINTET ÉRT EL



János Tóth

(sponsor: Annamária Muladi)
 "Për mua sekreti i suksesit është: Vendos!
 Merr përsipër përgjegjësinë për të! Lufto me
 veten çdo ditë!"



NIVELIN E MENAXHERIT E ARRITËN



Gábor Mogyoródi & Anna Soós

(sponsor: János Tóth)
 „Merr në shënjë Hënë! Edhe sikur të
 gabosh midis yjesh do biesh”

Les Brown



NIVELIN E SUPERVISOR-I E ARRITËN

Bulyáki-Jenei Szilvia Dr. Bulyáki-Jenei Sándor
 Glazar Doroteja
 Győri Pál Jenő & Győri Pál Jenőné
 Hegyi László & Hegyi Dominika
 Huszai Erzsébet & Huszai Attila

Illés Györgyné
 Juhász Imréné & Juhász Imre
 Kavcsásnszki Erzsébet
 Kleva Danko
 Knežević Tanja & Knežević Mato
 Kovács Istvánné
 Pelsőczy László Györgyné & Pelsőczy
 László György

Pevc Ales & Pevc-Urbancić Andrejka
 Šoštarić Zana
 Szabóné Uhrin Éva
 & Szabó Bálint László
 Szabóné Varga Zsuzsa & Szabó Imre
 Szolga Szilvia
 Uršić Stanko
 & Fister Uršić Suzana



FITUESIT E PROGRAMIT MOTIVUES TË BLERJES SË MAKINËS

NIVELI 1-rë

Jožica Arbeiter & Dr. Miran Arbeiter
 Becz Zoltán & Kenesei Zsuzsanna Viktória
 Bruckner András & Dr. Samu Terézia
 Budai-Schwarz Éva
 Marija Buruš & Boško Buruš
 Csuka György & Dr. Bagoly Ibolya
 Davis Erika & Davis Henry
 Dr. Dósa Nikolett
 Éliás Tibor
 Fekete Zsolt & Ruskó Noémi
 Ferencz László & Dr. Kézsmárki Virág
 Olivia Gajdo
 Gecse Andrea
 Gombás Csilla Anita & Gombás Attila
 Gyurik Erzsébet & Sándor József
 Hajcsik Tünde & Láng András
 Heinbach József & Dr. Nika Erzsébet
 Hertelendy Klára
 Rinalda Iskra & Lučano Iskra
 Dragana Janović & Miloš Janović
 Juhász Csaba & Bezzeg Enikő
 Sonja Jurović & Zlatko Jurović
 Dr. Keresztényi Albert
 Kis-Jakab Árpád & Kis-Jakabné Tóth Ibolya

Dr. Kiss Ferenc & Dr. Nagy Ida
 Klaj Ágnes
 Jadranka Kraljić-Pavletić & Nenad Pavletić
 Kúthi Szilárd
 Lopicz Tibor & Lopiczné Lenkó Orsolya
 Mázás József
 Dr. Molnár László & Dr. Molnár-Stantić Branka
 Muladi Annamária
 Nagy Ádám & Nagyné Belényi Brigitta
 Nagy Andrea
 Vaselije Njegovanović
 Dr. Marija Ratković
 Dr. Rokony Adrienne & Dr. Bánhegyi Péter
 Sebők Judit
 Senk Hajnalka
 Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin
 & Dr. Seres Endre
 Sulyok László & Sulyokné Kökény Tünde
 Dr. Szénai László &
 Dr. Szénainé Kovács Gabriella
 Tanács Ferenc & Tanács Ferencné
 Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona
 Varga Józsefné
 Jozefa Zore
 Zsidai Renáta

NIVELI 2-rë

Haim Józsefné & Haim József
 Kása István & Kása Istvánné
 Leveleki Zsolt & Leveleki Anita
 Dr. Németh Endre & Lukácsi Ágnes
 Orosházi Diána
 Siklósné Dr. Révész Edit
 & Siklós Zoltán
 Tihomir Stilin & Maja Stilin
 Utasi István & Utasi Anita

NIVELI 3-rë

Berkics Miklós
 Tomislav Brumec & Andreja Brumec
 Halmi István &
 Halminé Mikola Rita
 Herman Terézia
 Krizsó Ágnes
 Stevan Lomjanski & Veronika Lomjanski
 Dr. Milesz Sándor
 Szabó József
 Tóth Sándor & Vanya Edina
 Vágási Aranka & Kovács András
Varga Róbert
& Varga-Hortobágyi Tímea



BASHKË NË RRUGËN E SUKSESIT

CONQUISTADOR CLUB

02. 2013. DHJETË DISTRIBUTORËT MË TË SUKSESSHËM NË BAZË TË PIKËVE PERSONALE DHE TË NON-MENAXHERIT

HUNGARIA



1. **Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona**
2. **Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin & Dr. Seres Endre**
3. **Dr. Németh Endre & Lukácsi Ágnes**
4. Senk Hajnalka
5. Varga Róbert & Varga-Hortobágyi Tímea
6. Rajnai Éva & Grausz András
7. Kovács Mihályné & Kovács Mihály
8. Tóth János
9. Tóth Tamás & Bostyai Emília
10. Ferencz László & Dr. Kézsmárki Virág

SERBIA



1. **Vitomir Nešić & Suzana Radić**
2. **Stevan Lomjanski & Veronika Lomjanski**

KROACI



1. **Manda Korenić & Ecio Korenić**
2. **Ivan Lesinger & Danica Lesinger**

60GG+

TË KUALIFIKUARIT 02. 2013.

Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona
Nešić Vitomir & Radić Suzana
Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin & Dr. Seres Endre
Tanács Ferenc & Tanács Ferencné
Dr. Németh Endre & Lukácsi Ágnes
Senk Hajnalka
Varga Róbert & Varga-Hortobágyi Tímea
Mázás József
Lomjanski Stevan & Lomjanski Veronika
Rajnai Éva & Grausz András

Éliás Tibor
Kovács Mihályné & Kovács Mihály
Tóth János
Tóth Tamás & Bostyai Emília
Brumec Tomislav & Brumec Andreja
Korenić Manda & Korenić Ecio
Ferencz László & Dr. Kézsmárki Virág
Lesinger Ivan & Lesinger Danica
Kurucz Endre
Dr. Szénai László & Dr. Szénainé Kovács Gabriella





DREJTIMI OPATIJA!

Nga 1 Maji fillon periudha e 3-të dhe e fundit e kualifikimit për Holiday Rally të këtij viti, që na pret në një qendër të re, në Opatija. Rrjetndërtuesit e sukseshëm, të kualifikuar disa herë për Holiday Rally, tashmë kërkojnë të binden për atë pse duhet të jenë patjetër atje në Tetor.

HOLIDAY RALLY

KUALIFIKOHU PËR HOLIDAY RALLY!



„EDHE MUA MË RRODHËN LOT“

Për herë të parë mora pjesë në Holiday Rally në 2009. Atëhere nuk isha kualifikuar zyrtarisht, por udhëtimi mu siguroi nga sponsori im, ku mora pjesë me dy supervizorë të mitë, duke qënë edhe vet supervizore. Për herë të parë morëm pjesë së bashku në një takim kaq voluminoz të Foreverit. Pas këtij momenti u binda se gjithmonë duhet të rikthehem këtu bashkë me skuadrën time. Në 2010, në thellësinë e linjës time u kualifikua një çift, Anna Katko (që ne e thërrasim Anikó) dhe Lajos. Isha shumë krenare për ta, sepse krahas 4 fëmijve dhe punës së tyre ndërtuan edhe biznesin e supervizorit. Anikó na tregonte se prej 20 vjetësh nuk kishin mundur të pushonin së bashku me të shoqin. Shetitën të lumtur dorë për dorë në bregdetin dalmat, dhe u mahnitën me nivelin e lartë të udhëtimit dhe akomodimit. Na tregoi për atmosferën e takimit dhe për atë sa shumë mësuam. U kthyen në Hungari jashtëzakonisht të frymëzuar, edhe mua më rrodhën lot, kur i dëgjova. Atëhere e kuptova vërtet se çfarë mund tu japim njerzve me Holiday Rally-in. Në 2011, tashmë me menaxheren time të parë u rikthyem si të kualifikuara në Porecs. Leksionet ishin fantastike. Tema qëndrore ishte: "Kush jam unë?" Ia vلente ta dëgjoje! Ishte me një përmbajtje të lartë frymëzuese, që do të më shoqërojë gjithë jetën. Nga 2009 deri në 2012, nga skuadra ime është kualifikuar dikush për udhëtimin e Porecsit. Ata u bënë shtylla e biznesit tim. Besoj me siguri të plotë se falë Holiday Rally-it, tashmë kam krijuar biznesin e qëndrueshëm të një menaxheri. U jam mirënjohëse bashkpunëtorëve të mi për dashurinë dhe punën e tyre plot durim



Hajnalka Serény menaxhere



József Mázás senior menaxher

„MJAFTON NJË FJALI, QË TË FITOSH DISA MILONA FORINTA“

Për mua Holiday Rally të ofron vlerat e mëposhtme: Ai që deri tani vetëm është rropatur, këtu do të gjejë rrugën për një jetë me nivel. Këtu mund të jetosh madhështinë e FLP, atë për të cilën flet ky biznes! Si fillestar apo si i ri, në atë fund jave të Holiday Rally-it mund të fitosh mënyrën e jetesës të Diamantit, mund ta shikosh vetë vlerësimin dhe atë që je në vendin e duhur. Pas asaj fund jave ndryshon qëndrimi yt, që të jep siguri të plotë. Kur bisedon me kandidatët e tu, sytë të lëshojnë xixa, biseda jote do të jetë bindëse, prezenca jote bëhet tërheqëse. Kjo ndodh sepse, kur flet për biznesin, flet me eksperiencën tënde, dhe jo me të dëgjuar, si një spektator i jashtëm. Gjithmonë kam endërruar ta shikoja një herë rezidencën e wikendit të presidentit amerikan në Camp David! Prandaj ky vend i Holiday Rally-it është i veçantë, sepse këtu flasin lirshëm dhe japin idetë e tyre nga mund të mësosh shumë, presidentë, njerëz të zgjuar, VIP-a, I tillë është Holiday Rally, ku japin mësim Miklós Berkics, Attila dhe Kati Gidófalvi, Veronika Lomjanski, Dr Sándor Milesz, Péter Lenkey e të tjerë, njerëz të tillë që kanë ndryshuar gjithë tregun botëror të MLM. Mjafton edhe një fjali, që mbas kësaj fund jave të Holiday Rally-it, të fitosh disa miliona forinta dhe të kesh rretin tënd më të madh se kushdo tjetër në historinë e deritanishme të FLP. Këtu mund të vendosësh lidhje të drejt për drejta me cilindo drejtues, të mund të marrësh përgjigje të menjëhershme për pyetjet e tua, dhe të largosh gjithë dyshimet e tua.

JAM MIRËNOHËS, QË MUND TË JEM PJESMARRËSE E HOLIDAY RALLY-IT

Për mua ka rëndësi të veçantë që të kualifikohesh për trainimin e organizuar në Opatija. Të mësuarit është pjesë e jetës sonë, është mjeti bazë për arritjen e objektivave tona. Në çdo takim apo trainim të organizuar nga firma duhet marrë pjesë. Kurrë nuk mund ta dish cila do të jetë ajo fjalë apo ndejenjë që të ndryshon gjithshka, të krijon një kthesë të re dhe një vrull tjetër në jetë. Trainimet të japin forcë për jetën e përditshme, edhe për përgjigjet „jo“ edhe për „po“-të. Për mua përvoja e vitit të kaluar në Porecs ishte e mrekullueshme dhe jam mirënjohëse që mund atë isha pjesë e atij Holiday Rally. Ai që është regjistruar tani dhe është i ri në këtë sipërmarrje, siguron një pasqyrë të jetës që bëhet në Forever, mund të mësojë për produktet, për teknikat e nevojshme të ndërtimit të këtij biznesi, kontakton me ata drejtues që me shembullin e tyre, me rezultatet, me modestinë e pabesueshme dhe me përkushtimin e tyre përfaqsojnë skuadrat e tyre dhe Foreverin e Hungarisë. You can do it!

Andrea Nagy senior menaxhere

„PUNO ME OBJEKTIVA, ME NDRERSHMËRI DHE ME ENERGJI“

Kush nuk do të donte të merrte një dhuratë? Sa herë keni marrë dhurata dhe vlerësime të tilla për punën tuaj të mirë? FLP është ajo, që ty që je element i rëndësishëm i ndërtimit të saj, që kur thua „u bëra supervisor“ të shpërblen, me pushim weekend-i në një hotel me 4 yje, me të gjitha falas. Rehat, argëtim...kush nuk do ta dëshironte këtë? Një dhuratë e vërtetë, plus mundësinë për të mësuar. Nga kush? Nga ata që i dinë si në majë të gishtave, atë që ty të duhet për ta mësuar. Je me fat sepse ata ta japin njohuritë e tyre pa egoizëm, përzemërsisht, dhe plot energji. Në atdhe kthehesh i frymëzuar, plot eksperiencë dhe me skuadrën tënde mund të fillosh punën tënde plot me energji të reja. Në qoftë se tashmë shkon me skuadrën tënde, për të cilën të duhet „vetëm“ që të punosh me objektiva, me nder dhe energji, pas ngjitjes të nivelit, prap shpërblimi i weekend-it është i yti, atëhere vendi yt ndodhet mindis „të mëdhenjve“, ata punojnë për ty në podium, që ti të jesh sa më i sukseshëm dhe që të kesh një skuadër sa më të madhe. Nuk besoj se në botë ka shumë firma të tilla, ku mund të marrësh po këtë gjë. Herën e parë, bashkë me bashkëshortin, shkuam atje vetëm se arritëm nivelin. Herën e dytë për krenari si menaxherë! Ndërsa herën e tretë me gjithë skuadrën, si senior menaxherë. Ishim krenar dhe të lumtur për skuadrën tonë, që sponsorit tanë Aranka Vágási dhe András Kovács, nga të cilët deri në ditët e sotme thithim njohuritë e shumta që ata disponojnë. Të kualifikohesh çdo vit për Holiday Rally është një ndjenjë e mrekullueshme, është një punë e madhe! Por pa objektiva dhe sfida ç'ia vlen jeta?

Erika Davis senior menaxhere



PROGRAMI STIMULUES

Programi Stimulus është një programvërtet në përmasa të gjëra; një nga stimujt më popullor të Foreverit. Programi stimulimit siguron të ardhura suplementare për distributorët, sido që të konvertohet, qoftë me një autoveturë, apo me kalim pushimesh diku. Për tu kualifikuar për të thjesht duhet siguruar sasia e pikëve në 3 muaj të njëpasnjëshëm në bazë të skicës së mëposhtme. Në rezultatit tënd të përgjithshëm llogariten edhe pikëk (CC) të arritura nga skuadra jote.

Një nga gjërat më të mira të këtij Programi Stimulimi është ajo që mund të kualifikohesh për një nivel të ri më të lartë, qoftë edhe menjëherë, në muajin që pason të parin, mbasi të kesh plotësuar edhe kushtet e muajit të tretë. Për shembull në qoftë se plotësove kushtet e nivelit të parë në Janar, Shkurt dhe Mars, atëhere në Prill mund të kualifikohesh për nivelin e 2-të apo të 3-të.

Kushtet për sigurimin dhe ruajtjen e të drejtës për programin stimulus

Muaji	Niveli 1-rë Pikët e plota (CC)	Niveli 2-të Pikët e plota (CC)	Niveli 3-të Pikët e plota (CC)
1	50	75	100
2	100	150	200
3	150	225	300

Niveli 1-rë: FLP paguan çdo muaj më e shumta 400 EURO, më e shumta për 36 muaj të njëpasnjëshëm

Niveli 2-të: FLP paguan çdo muaj më e shumta 600 EURO, më e shumta për 36 muaj të njëpasnjëshëm

Niveli 3-të: FLP paguan çdo muaj më e shumta 800 EURO, më e shumta për 36 muaj të njëpasnjëshëm

Përshkrimi i mësipërm nuk përmban të gjitha kushtet dhe rregullat e Programit Stimulus. Përshkrimin e tyre më të zgjeruar, mund ta gjeni në Politikën e Kompanisë, lutemi studjoni me kujdes dhe konsultohuni me sponsorin dhe linjën tuaj të mësipërme!

**DO TË DËSHIROJE NJË MËNYRË TË TILLË JETESE, TË CILËN E KE DËSHIRUAR
GJITHMONË? ATËHERE KUALIFIKOHU PËR PROGRAMIN STIMULUES!**



Në revistën tonë kemi nisur një rubrikë të re, në të cilën rrjetndërtues të dalluar rekomandojnë libra të tilla që kanë patur ndikim të veçantë në mendimin dhe zhvillimin e tyre personal. Serinë e hap Menaxheri Diamant-Zafir Róbert Varga.

Kur mora për herë të parë këtë kërkesë, redaktorët mu lutën rubrika të përmbajë dy-tre libra. Nuk e kisha menduar se përzgjedhja do të ishte kaq e vështirë, sepse gjatë 20 viteve të shkuara, kam lexuar më shumë se një mijë libra, dhe secili libër ka patur ose ka një ndikim të veçantë në jetën time. Kur bëra llogarinë, në fillim mu duk shumë, por pastaj u binda, që i binte vetëm një libër në javë, domethënë leximi i 20-40 faqeve në ditë.

KEITH ELLIS: LLAMPA ÇUDIBËRËSE

Ky libër bën fjalë për objektivat, dhe rëndësinë e caktimit të objektivave në mënyrën më të thjeshtë, që mund të kem lexuar për këtë temë. Se si ti realizosh objektivat e caktuara? Mund ta mësosh nga ky libër.



NAPOLÉON HILL: MENDO DHE PASUROHU!

Në fillim e lexova me inat e mosbesim, dhe pastaj erdhi vlerësimi për të: 1. Për çdo gjë, e mirë apo e keqe, që më ka ndodhur deri tani në jetë, jam unë dhe vetëm unë përgjegjës! 2. Në qoftë se jam unë shkaktari i vështirësive, atëhere edhe zgjidhja qëndron brënda meje! 3. Sa më e madhe sfida, aq më i madh është edhe shpërblimi! Në çdo vështirësi apo problem, që kam patur si sprovë diku në jetë, në qoftë se e kam zgjidhur, më ka sjellë dhjetë apo një qind herë rezultate më shumë.



BRIAN TRACY: RIKRIJOJE JETËN TËNDE!

Kushdo që në çfardo fushë të jetës (për shembull në biznesin e FLP) do që të arrijë sukses, së pari duhet të rindërtojë apo „mbledhë” veten.

Një libër i mrekullueshëm, me mendime të mrekullueshme! Radhën nuk mund ta ndërroj!



NATYRISHT NJË DHE NJË
ËSHTË SHUMË MË TEPËR
SE DY - FOREVERI MUND TË
TË MËSOJË EDHE PËR KËTË.
MEGJITHËSE ISTVÁN UTOSI
U BË SAFIR MENAXHERË ME
FORCAT E VETA, PUNA E TIJ
MORRI NJË HOV TË RI, KUR
ANITA NUK U LIDH VETËM
TEK JETA E TIJ, POR EDHE TEK
RRJETI I TIJ.

Sponsor: Katalin Gulyás

Linja e sipërme: Andrea Gecse, Róbert Varga, Zsolt Leveleki, Terézia Herman, Zoltán Becz dhe Zsuzsi

Të ndryshosh në njeri më të mirë

ISTVÁN DHE ANITA UTASI SAFIR MENAXHERË

Rrjeti i Utasit ekziston prej pesëmbëdhjet vjetësh, dhe nëntë vjet e ndërtojnë së bashku. Anita, në fakt ti si i re në sy, si bashkpuntore e zgjedhur?

Anita: Jo, ndodhi e kundërta, unë desha ta futja atë në një biznes tjetër MLM, por krahasuam të dy planet e marketingut, provova produktet dhe pashë, që me po aq punë në Forever mund të fitohet shumë më tepër. Me produktet u dashurova menjëherë. Pa folur pastaj për Istvánin! E futa veten brenda në ndërtimin e rrjetit, arrita nivelin e supervizorit - si front i Istvánit.

István: Atëhere ishim akoma thjeshtë kolegë, as nuk e kisha menduar, që mund të bëhej edhe diçka më shumë. Pastaj kur i lidhëm bashkë jetët tona, atëhere bashkuam edhe bizneset tona.

Në këtë periudhë ti ishe tashmë në nivelin e Safir menaxherit. Ke pasur më parë përvojë MLM-je?

István: Vetëm besoja, që kam. Munda ta imagjinoj, që sistemi mund të funksionojë, por e vërteta është, që në praktikë nuk funksionoi rrugë tjetër - të paktën mua jo.

Kur fillove ta ndërtosh rrjetin si antar i Foreverit, me çfarë shpejtësie filloi biznesi yt?

István: Mund të them që filloi shumë ngadalë. Zgjati një vit e gjysëm, deri sa filluam të jetonim prej saj bashkë me familjen time. Por nuk është çudi, sepse atëhere punoja në tre vende: në të njëjtën kohë isha mekanik makinash, roje sigurie dhe agjent siguracioni. Kështu që nga ajo kohë nuk mund të më thotë mua askush, që nuk ka kohë...

Në këto momente e thua shembullin tënd ?

